

Letra

I nderumi koleg, Astrit Kola!

E mora kumtin tuj dhe deshta me iu ba me dije do gjana:

1. Derisa keni akses n' Arkivin e Shtetit merrni dhe botoni fjalimin e Ahmet Zogut n' parlament n' janar 1925, pas rikthimit n' Tirane. Atehere do ta shifni se keni pergenjeshtru vete Ahmet Zogun, tuj mos i qujte kundersharet e atij si komuniste. Ahmet Zogu thote atje se ka rrezu nji qeveri komuniste.

2. Kur thoni se Noli, Rustemi etj. nuk kane qene komuniste, tuj u bazu n' programin e P. Populllore, nuk po thoni naj gja t' besueshme sepse edhe Enver Hoxha nuk paraqiti zyrtarisht nji program komunist deri n' 1948, kur PKSH u qit prej ilegalitetit. Deri m' atehere u mshef pas Frontit N-CI (Demokratik pas 1945).

3)Referenca tek "Thirrja e Pare" e vitit 1941 asht absurde per shkak se komunistat e 1941 nuk dojshin ta paraqitshin Nolin dhe Revolucionin e 1924 si komunist, per shkak se sipas teorise marksiste-leniniste, u dojte me e paraqite si Revolucion Demokratiko-Borgjez, se kshtu u delte llogaria me etapat revolucionare sipas skemes: Lvizja fshatare antifeudale (rebelimi i Haxhi Qamilit)-Revolucion Dem-borgj (Noli 1924).

4) N' parlamentin shqiptar n' 1924 u mbajt zi per Leninin, por veq prej leninistave (Noli, Rustemi etj.). N' rast se e mohoni ket bani punen e atyne qi sot dun me reabilitu leninistat e 1924-s, tuj i paraqite si demokrate.

5)Tash jeni tuj ba dialog apo monolog? N' rast se jeni tuj ba polemike me mu, atehere e botoni, n' mos repliken teme me ju, s' pakut ket pergjegje temen, qi u referohet tezave t' paraqitme prej jush n' dy numrat e fundit t' "Atdheu". Kuptohet, n' rast se nuk keni droje me i dhane lexuesit pikpamjet e t' dy paleve, pra n' rast se besoni n' forcen e ideve tuja. N' rast se keni probleme me gjuhen n' t' cilen kam shkrujte, e bani vet perkthimin sikur keni ba me shkrimet e mia tek "Liria".

Me respekt

Kastriot Myftaraj

Ja pergjigjja e kryeredaktorit te "Atdheu"-t Astrit Kola

I nderuari koleg, Kastriot Myftaraj!

Mesazhin tuaj ne adresen time po e botoj ne gazetën "Atdheu", me qellim qe lexuesit e paanshem te behen me dije per verejtjet tuaja, te cilat mendoj t'i analizoj dhe trajtoj ne vijim te polemikes sime. Por gjithsesi ndjej detyrim qe te pergjigjem shkurtimisht lidhur me to! Se pari, z.Myftaraj, une nuk po bej monolog, por nje polemike serioze, bazuar mbi fakte dhe interpretime te problemeve ne fjalë, per te cilat mendoj se ezaurojne mjaft nga te vertetat qe trajtohen.

Perderisa po u pergjigjem tezave dhe argumentave tuaj, te trajtuara ne rreth 14 numra ne gazetën "TemA", mendoj se nuk po bej monolog, sikunder ironizoni ju.

Une besoj ne forcën e ideve te mia, ashtu sikurse besoj ne forcën me te cilën ju mbroni idete tuaja.

Ndersa lidhur me gjuhën me te cilën ju shkruani, ajo nuk eshte e huaj, as per vendlindjen time dhe as per shijet e mia, pavarësisht se polemika ime eshte shkruar ne gjuhën letrare.

Gjuha juaj ne mesazhin e mesiperm, nuk eshte gjë tjetër veçse gjuha e aprovuar ne Kongresin e Manastirit dhe me te cilën shkruan shqiptaret per afro 6 dekada. Ne kete gjuhë une kam

lexuar korifejtë e letrave shqipe si Fishta, Mjeda, Koliqi, Camaj etj., dhe kryeveprat e tyre i kam shijuar plotësisht.

Dikur, në gazetën “Liria” unë, në rolin e kryeredaktorit, nuk kam përkthyer nga shqipja në shqip shkrimet tuaja, por vetëm i kam transliteruar në shqipen letrare, për lehtësi në të kuptuar nga lexuesit, dhe nuk kam patur kurrfarë qëllimi të mbrapshtë, sikundër aludoni.

Nëse keni ndonjë vërejtje për “përkthim” në shqipen letrare të citimeve tuaja në ligjëratë të drejtë në polemikën time, atëherë mund të ma përcaktoni se në cilin rast bëhet fjalë, dhe unë do ta korrigjoj menjëherë në vazhdim. Por mendoj se nuk e kam bërë një gjë të tillë.

Me respekt!

Astrit Kola

Marrë nga gazeta "Atdheu"